



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

**UDHËZIM**

Nr. 13, datë 17.07.2020

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES DHE SHPËRBLIMIT TË EKSPERTËVE TË JASHTËM TË PAVARUR, TË CILËT ANGAZHohen NË KRYERJEN E KONTROLLEVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 58, pika 8, të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”,

**UDHËZOJ:**

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i kriterëve, procedurave të përzgjedhjes dhe shpërblimit të ekspertëve të jashtëm të pavarur, të cilët angazhohen për kryerjen e kontrollit të veprimtarisë së përmbarruesve gjyqësorë privatë, në rastin e mungesës së burimeve njerëzore në strukturën përgjegjëse në ministri, si dhe mbulimit të fushave specifike.

2. Ministria e Drejtësisë miraton jo më vonë se data 10 shkurt të çdo viti kalendarik, një listë me jo më pak se 25 (njëzet e pesë) ekspertë të jashtëm të pavarur, që mund të angazhohen për kryerjen e kontrolleve, të përzgjedhur sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

3. Procesi i paraqitjes, trajtimit të shprehjes së interesit dhe të verifikimit të plotësisë të kushteve ligjore nga kandidatët, bëhet duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor, si edhe parimet e përgjithshme të procedurës administrative, veçanërisht ato të ligjshmërisë, transparencës, informimit, të drejtësisë, të paanësisë, të mbrojtjes së të dhënave, konfidencialitetit e të sekretit shtetëror.

4. Kandidati që kërkon të përfshihet në listën e ekspertëve të pavarur, që mund të angazhohet për kryerjen e kontrolleve, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, ekonomi, shkencë inxhinierike ose në një fushë tjetër të ngjashme me të, me diplomë “Master i shkencave”;
- c) të ketë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet përvojë pune në profesion;
- ç) të mos jetë i dënuar më parë për kryerjen e një veprë penale;
- d) të mos jetë i pushuar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi në çastin e paraqitjes së shprehjes së interesit;
- dh) të ketë një profil të spikatur shoqëror, integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale;
- e) të mos jetë përmbarues ose bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë të mos jenë përmbarues;
- ë) në kohën e kandidimit, të mos ketë qenë i punësuar ose i angazhuar si ekspert, këshilltar, përfaqësues ose avokat, për të paktën 5 (pesë) vjet, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, pranë një përmbaruesi ose zyre përmbarimore private.

5. Ministria e Drejtësisë, jo më vonë se data 10 dhjetor e çdo viti publikon në faqen zyrtare të saj njoftimin për paraqitjen e shprehjeve të interesit për t’u përfshirë në listën e ekspertëve të pavarur. Thirrja për shprehjen e interesit:

- a) duhet të jetë e hapur për të paktën dy javë përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të tyre; si dhe
- b) duhet të përcaktojë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar për t’u dorëzuar bashkë me shprehjen e interesit.

6. Kandidati i interesuar për t’u përfshirë në listën e ekspertëve të pavarur, duhet të depozitojë me postë, dorazi në protokollin e Ministrisë së Drejtësisë, apo në rrugë elektronike, dokumentacionin vërtetues të plotësimin të kushteve, si më poshtë:

- a) shprehjen e interesit me shkrim;
- b) jetëshkrimin e përditësuar;
- c) kopje të dokumentit të identifikimit;
- ç) kopje të diplomës, që vërteton përfundimin e ciklit të dytë të studimeve universitare për fushën përkatëse të ekspertizës, ose diplomë të njësuar me të;
- d) kopje të librezës së punës ose vërtetim se kandidati ka plotësuar detyrimet fiskale dhe ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga administrata tatimore për tre muajt e fundit;
- dh) autorizim për verifikimin e gjendjes gjyqësore;
- ë) një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore se nuk ka asnjë anëtar të familjes, si dhe të afërm të shkallës së parë që është përmbarues gjyqësor privat në detyrë;
- f) një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore se nuk ka qenë i punësuar me kohë të plotë ose të

pjeshme ose nuk ka qenë i angazhuar si ekspert, këshilltar, përfaqësues ose avokat për të paktën 5 (pesë) vjet, pranë një përmbaruesi ose zyre përmbarimore private;

g) çdo dokument tjetër që vërteton përmbushjen e kushtit të parashikuar në pikën 4, shkronja “dh”, të këtij udhëzimi.

7. Jo më vonë se data 15 janar e çdo viti kalendarik, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë verifikon nëse kandidatët që kanë paraqitur shprehjen e interesit plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 4, të këtij udhëzimi. Lista me kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe lista me kandidatët që nuk plotësojnë kushtet bëhen publike në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

8. Kandidatët e përjashtuar njoftohen me shkrim, individualisht dhe në mënyrë të arsyetuar për shkaqet e përjashtimit. Ata mund të ankohen brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit pranë ministrit të Drejtësisë. Ministri vendos brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e depozitimit të ankimit. Ndaj vendimit të ministrit mund të paraqitet ankim në gjykatën administrative të shkallës së parë.

9. Jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas përfundimit të afatit të ankimit ose pas shqyrtimit të ankimeve nga ministri, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë i përcjell ministrit për miratim listën me ekspertët e pavarur, e cila, pas miratimit, publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

10. Në rast se në përfundim të procedurave si më sipër, lista me ekspertë të pavarur ka më pak se 25 (njëzet e pesë) ekspertë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë pas kalimit të 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të listës, sipas pikës 9 të këtij udhëzimi, rishpall thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit sipas pikës 5, të këtij udhëzimi. Thirrja shpallet çdo 30 (tridhjetë) ditë pas përfundimit të procedurave të përzgjedhjes, sipas këtij udhëzimi, deri sa lista e ekspertëve të pavarur të ketë jo më pak se 25 (njëzet e pesë) ekspertë.

11. Lista e miratuar është e vlefshme deri me miratimin e listës për vitin pasardhës, sipas procedurave të këtij udhëzimi.

12. Masa e shpërblimit të ekspertëve të përzgjedhur është në vlerën 7 000 (shtatë mijë) lekë për ditë pune, në të cilat do të angazhohen, dhe pasqyrohet në kontratën e shërbimit që do të nënshkruhet me çdo ekspert të pavarur të përzgjedhur, kontratë në të cilën do të detajohen edhe kushtet dhe mënyra e livrimit të saj.

13. Në rastet kur eksperti i jashtëm dërgohet për inspektim jashtë qendrës së tij të punës, ai trajtohet edhe me dietë, sipas kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.

14. Pagesa e ekspertëve të jashtëm përballohet nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë.

15. Për kryerjen e një inspektimi, ministri, me urdhër, cakton një ose disa ekspertë nga lista e ekspertëve të pavarur, të miratuar sipas këtij udhëzimi. Urdhri i ministrit të Drejtësisë, për përzgjedhjen e ekspertit dhe pjesëmarrjen e tij në inspektimin përkatës, përmban:

- a) detyrat që i caktohen ekspertit;
- b) afatin për paraqitjen nga eksperti pranë Ministrisë së Drejtësisë, të raportit me shkrim ku parashtrihen përfundimet e ekspertimit;
- c) sipas rastit, urdhërimin e subjekteve të treta për t'i lejuar ekspertit kryerjen e detyrave të caktuara nga ministri i Drejtësisë.

16. Urdhri sipas pikës 15 të këtij udhëzimi, i bëhet i njohur ekspertit të pavarur, duke i njoftuar edhe datën e paraqitjes në inspektimin përkatës, të caktuar nga ministri i Drejtësisë.

17. Ministri i Drejtësisë i cakton ekspertit të përzgjedhur nga lista e ekspertëve, çështjet për të cilat duhet të merret mendimi me shkrim i tij. Përgjegjësia për saktësinë dhe vërtetësinë e ekspertimit, brenda fushës së kompetencës, i mbetet ekspertit. Eksperti është i detyruar të shpërblejë dëmet që për faj të tij i janë shkaktuar përmbaruesit ose zyrës përmbarimore private ndaj së cilës zhvillohet inspektimi apo palëve të tjera, të përfshira në procesin e inspektimit.

18. Eksperti është i detyruar të përmbushë detyrat e ngarkuara nga ministri i Drejtësisë, sipas afateve të përcaktuara, përveç kur parashtron shkaqe të arsyeshme që pranohen nga ministri i Drejtësisë. Eksperti, që nuk pranon të kryejë detyrën, duhet t'i njoftojë me shkrim ministrit të Drejtësisë shkaqet përkatëse të paktën 5 (pesë) ditë përpara datës së inspektimit. Mospërmbushja në mënyrë të përsëritur e detyrave të caktuara nga ministri i Drejtësisë, pa shkaqe të arsyeshme, sjell përjashtimin e ekspertit nga lista.

19. Ekspertët e përzgjedhur, brenda kompetencave të dhëna me ligj, janë plotësisht të pavarur në kryerjen e ekspertimit dhe në paraqitjen e përfundimit të ekspertimit për rastin konkret.

20. Eksperti i përzgjedhur ka të drejtë të kryejë veprimet e mëposhtme:

- a) të njihet me materialet e çështjes për inspektim;
- b) t'i bëjë pyetje përmbaruesit, përfaqësuesit ligjor të zyrës përmbarimore ose çdo punonjësi tjetër të zyrës përmbarimore, pranë të cilit bëhet inspektimi, sipas fushës specifike për të cilën është angazhuar eksperti në këtë inspektim;
- c) të japë shpjegime;
- ç) të kërkojë e të marrë të dhëna nga të tretët, brenda kufijve të nevojshëm për kryerjen e detyrës.

21. Ministri i Drejtësisë i kërkon ekspertit të pavarur që të japë përfundimet e ekspertimit, sipas detyrave të dhëna në fillim të inspektimit, në një raport me shkrim, ku duhet të gjejnë pasqyrim edhe vërejtjet apo kërkesat e nëpunësit të strukturës përgjegjëse për inspektimin në Ministrinë e Drejtësisë, pjesë e ekipit të inspektimit apo edhe të përmbaruesit ndaj të cilit kryhet inspektimi. Në